

**Ermira YMERAJ**

**ARKETIPI I HEROINËS FEMËRORE TE MIGJENI, KADARE, KONGOLI**

**DHE KOLIQUI**

UDC 821.18.09

**Abstrakti:** *A kanë krijuar këto autorë, personazhe dhe karaktere femërore të imagjinuara apo arketipe me bazë të vërtetën reale e të hidhur të kohës së tyre?*

*Sjellja e femrës dhe pranimi i saj në letërsinë shqiptare si heroinë qendrore, gjithmonë për të kthjelluar e interpretuar rolin e vendin e saj në shoqëri ka një qëndrim të dallueshëm tek të katër shkrimtarët. Me orientime letrare e formime në kohë të ndryshme, janë përpjekur t'i komunikojnë lexuesit arketipin e gruas të rënë, të çmendur, fatale, të venitur, të pabarabartë, me tipare dhe karaktere që i përkasin realitetit shqiptar që ndiqet nga një kohë po aq e çmendur, fatale, e venitur dhe e pabarabartë. Objekti esencial i ekzistencës së femrës te këto shkrimtarë, mbart motivin e femrës tipike që i përgjigjet, “pabarazisë gjinore”; “nëpërkëmbjes së identitetit”; “pasjes dhe shkëljes së sensualitetit”; “fisnike dhe e refuzuar”, “seksi i dytë”; “me ambicie që u mbyten dhe u shtypen”, “të dënueshme”.*

*Autorët e ndërtojnë topikën e heroinës përgjatë marrëdhënieve ndërmjeshore mbi norma morale të shkelura nga koha, kërkojnë ndryshime strukturash dhe raportesh, ndryshim të formave “burrërore”, ndryshim mentalitetesh, kërkojnë çlirim të gruas, një botë ku gruaja nuk duhet të jetojë vetëm përmes historizmit të rolit të paravendosur si krijesë e dobët<sup>1</sup>.*

**Fjalët kyçe:** *topikë, heroinë, norma morale, karaktere*

**Subject:** *Female heroin archery at Migjeni, Kadare, Kongoli dhe Koliqi*

**Abstract:** *Have these creators, characters and feminine characters imagined or archithetically based created the real and bitter truth of their time?*

*Women's behavior and its admission to Albanian literature as central heroine, always to clarify and interpret the role of her place in society has a distinct stance on all the four writers.*

*With literary orientation and formations at different times, they have tried to communicate to the reader the fallen, crazy, fatal, faded, unequal woman with the features and characters belonging to the Albanian reality that is followed by a time as crazy, fatal, faded and uneven. The essential object of the existence of women in these writers carries the motive of the typical female responding to “gender inequality”; “Theft of identity”; “Having and sensualizing violation”; “Noble and rejected”, “second sex”; “With ambushes that drowned and crushed”, “punishable”.*

*Authors build the heroine's temptation over interpersonal relationships over time-worn moral standards, require changes in structures and relationships, change of “manly” forms, mentality change, seek women's liberation, a world where women should not only live through history the role of predestined as a poor creature<sup>2</sup>.*

**Keywords:** *topics, heroin, moral norms, characters*

<sup>1</sup> Përfaqësimi është po aq produkt i komunikimit aq edhe kusht primar për ekzistencën e tij, (Duvven: 2000: f. 12-13

<sup>2</sup> Representation is equally the product of communication as well as the primary condition for its existence, Duvven: 2000: f. 12-13.

Përballë kemi katër identitete letrare në ndërtimit të heroinës femërore përgjatë dy shekujve. Koliqi dhe Migjeni, janë shkrimtarë që sjellin në letërsinë shqipefemrën tipike që i përgjigjet, “pabarazisë gjinore”; “nëpërkëmbjes së identitetit”; “pasjes dhe shkeljes së sensualitetit”; “fisnike dhe e refuzuar”, “seksi i dytë”; “me ambicie që u mbytn dhe u shtypën”, “të dënueshme”.

Kadare dhe Kongoli janë dy shkrimtarë që *ndërtojnë* topikën e heroinës përgjatë marrëdhënieve ndërnjerëzore, e *shfaqin atë në* ndryshim raportesh, ndryshim të formave dhe mentalitetit. Kërkojnë çlirim të gruas duke i ikur rolit të paravendosur si krijesë e dobët.

Koliqi:

Gruaja vetësakrifikuese që shet trupin, është e vetme përballë paafësisë së mashkullit për të reaguuar<sup>1</sup>, përjetojnë dramën më të madhe të ekzistencës njerëzore, ajo përballë në mënyrë të vetëdijshme me një vetësakrifikim të pashmangshëm, që do t’i shkatërronte rininë, që do t’i përdhoste personalitetin, por do ta ndihmonte të mos vdiste urie. Koliqi e njih mjaft mirë psikologjinë e shqiptarëve për këtë shpreh hapur kundërshtinë e tij ndaj stereotipit të përhapur të shqiptarit, e njih kodin e vlerësimit, ndaj Diloca e tij bën pjesë në grupin e madh të personazheve femra që nuk është e privilegjuar nga fati, sepse ai nuk mund të jetë i ndryshëm për asnjë çast nga ai i femrave të shtresës që përfaqësojnë, fati i tyre është tashmë ipërcaktuar. Diloca nuk mund të ndryshojë asgjë, është e pafuqishme, mbetet një zë i ëmbël. Diloca, pas një drame të rëndë dashurie të pamundur, strehohet në një shtëpi shkodrane të pasur, ku ndihmon nënën e Lecit në punë shtëpisë. Ajo është e trishtuar, e trembur, pothuajse e përhumbur, për shkak të konflikteve të brendshme që i kishin tronditur shpirtin, si pasojë e shkeljes së zakoneve të maleve. Diloca “s’din me kallzue kurgja”, nuk mund të flasë e as të tregojë asgjë për atë të fshehtë që e mundon dhe që vetëm e ndryshon përbrenda. Leci sheh te ajo vetëm një figurë e heshtur që këmbëngul vazhdimisht të mbetet e tillë, edhe pse ai fillon të mendojë “nuk kishte me qenë marrë aq e madhe m’u martue me shërbtoreshen... do t’ifrymsojsha ndiesi të reja zemrës së saj që s’din... e të shifshim dashurin që tue lulzue nëtë me hovin e prandverave t’egra...”<sup>2</sup>. Diloca heq dorëhaptazi nga mundësia e sigurt për një të ardhme të mirë, ajo e pranon realitetin ashtu siç është, i nënshtrohen me shpirt të zbrazur e të copëtuar nga brenga, nuk këmbëngul për rrugëzgjdhje, nuk i intereson më të gjë një zgjidhje, çdo gjë do të ishte e kotë, sepse Diloca nuk do të mund të shijojë kurrënjë jetë të re, ajo e ka humbur tashmë betejën e jetës së saj.

Te Koliqi figura femërore nuk ka maskë, ai hyn në thellësinë e shpirtit të femrës, në energjinë shpirtërore të pashuar të saj”. Te Koliqi femra shndërrohet në viktimë e pashmangshme e shoqërisë. Figura femërore është tepërtërheqëse, lë mbresa të jashtëzakonshme, por që fatkeqësisht shkakton vetëm dhembjedhe keqardhje për fatin e saj të nënshtrohet ndaj ambientit të mbyllur e meskëndhe rregullave e ligjeve të egra kanunore të maleve shqiptare por kanë guximin të reagojnë, të përmbushin instinktin e tyre qoftë duke i dhuruar vetes pak momente gëzimi, qoftë duke i dhënë fund asaj llojvuajtjeje që do ta shoqëronte pashmangshmërisht gjatë gjithë jetës.

Realiteti i maleve shqiptare është tepër i ashpërpër brishtësinë e një femre, por ato janë rritur në këto male dhe e dinë mirë të fshehtën etyre. Dramat familjare janë tepër të dhimbshme dhe procesi i vrasjeshtrihet deri në thalb të tyre, pa njohur asnjë kufi. Babai vret të bijën, vetëm sepse kodi zakonor e kërkonte këtë. Minja dënohet pa mëshirë, jo vetëm nga i ati, që “nuk kishte sy e faqe me

<sup>1</sup> E. Koliqi, *Rrokoll*, f.248.

<sup>2</sup> E.Koliqi, *Diloca*, në *Vepra 2*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 146.

dale në kuvend të burrave”, por edhe nga ambienti e shoqëria, “Kush mund t’i pritetpëshpëritjet e gojve të këqija të malit...”.Këto femra janë të përgatitura për atë që do të ndodhë,i dinë tashmë rregullat e ngurtësuarat prej shekujsh në mendjet e shpirtat e njerëzve, eprandaj janë të vetëdijshme për fatin e tyre. Një femër tjetër që pëson këtë shndërrim ekzistencial dheqë është e destinuar të prekë ekstremin tjetër vdekjeprurës është Mrika te novela *Ke trelisat*. Në fillim e shohim si një vajzë të re që mbush shtëpinë plot jetë dhe hare, që ngjanme “një princeshë të mëshahun në petka katundarje,” por që shumë shpejt do tëshndërrohet, sipas të njëjtave procese të brendshme, në një “shakë të ndytë, bastardhe ehore të keqe” që lypset vra si qen. Ajo nuk është më e ndryshme se të gjitha femrat e tjera, është gjashtëmbëdhjetë vjeçe, tepëre njomë për t’u përballur me një dramë aq të madhe, që do t’ia shuante dhunshëmndjenjat që i flakëronin në shpirt e do t’i kushtonin gati edhe jetën. Përballë është figura e mashkullit, përherë si përcaktuesi i vetëm i fatit të saj. Dhe femrambetet gjithnjë nën hijen e tij, kokulur dhe e nënshtruar, e gatshme të zbatojë çdovendim, sepse në të kundërt do ta paguajë me jetën. Mashkulli është i vendosur, për t’ishkuar me gjakftohtësi deri në fund zgjidhjeve fatale, pa asnjë brejtje ndërgegjeje, paasnjë pendim, me bindjen e plotë se zakoni i maleve duhet respektuar. Zeka, i vëllai, “i arrasi një grusht të madh në zemër” dhe pastaj “i a ngrehi pushkën në gjoks, i tërbuem”,vetëm sepse Mrika u përpoq të shpëtonte nga vdekja e sigurt Gacin, djalin që dashuronte. Femra e kopshtit të kujtimeve, nuk mungon te Koliqi, ajo vjen si imazh, si mendim, si ndjenjë<sup>1</sup>. Mall e rrëmben, ajo ka mbetur ende gjallëqë nga koha e moshës së humbur, duke treguar se e ka provuar ndjenjën, të cilën e ka ruajtur me shumë fisnikërigjatë gjithë atyre viteve të gjata jete. Dhe tani, që ajo e ka pranë atë figurë të dashur të rinisë, nuk mund të ndjejë veçse mall.<sup>2</sup>Kjo do të thotë se femra e Koliqitështë mbartëse e një bote të tërëshpirtërore.

### Migjeni

Femra në psikologjinë e shqiptarit ka këtë konfigurim: Ndjenja të forta të sensit të nderit dhe idealin e shtëpiakes së përkryer. Femra që në folklor është e mveshur me imazhe floreale.<sup>3</sup> Migjeni dialogon me lexuesin e vet përmes thyerjeve të koncepteve konfiguruese të femrës me ndjenja të forta të sensit të nderit.

*“Kush nuk e kujton? Kush e kujton, or shok, atë? Kë? Cilën? Cilën? - Atë! Njenën nga ato! - Po cila asht njena nga ato? Ato jan shumë! Cili i ri (ose plak) nuk njef se paku dhetë nga ato?! Pse ato janë shumë. Pse shumë ka meshkuj, shumë ka pare, prandaj duhet në numër relativ të kenëdhe trupna që shiten... Pra, kush asht njajo njena nga ato?*

<sup>1</sup> Letërsia, shkruan E. Gajeri në *Femminismo e “gender studies”* ka qenë gjithmonë vendi “in cui si elabora e tramanda il complesso di immagini, figure esemplari e miti originali sia dalla tradizione che dal pensiero delle donne. Solo grazie alla letteratura sono leggibili i miti e i personaggi letterari – Semiramide, Didone... E. Koliqi, *Shënim*, f. 360.

<sup>2</sup> “Kur ai në kopësht të heshtun kërkoi hijen e ditve të sosuna nuk dridhej i vetëm n’at ndjesi të mallëngjyeshme. Plaka, tue e ndjekë ndër lëvizje të tija, bashkohej shpirtnisht me të... Ndieu prap një shije verash të fikuna, stinësh të largta qi sidomos mbasi predojnë na lanë në shpirt lumin plot shqetësim t’amës së tyne të mrekuallueshme”

<sup>3</sup> Jurij Llotman, “Fenomeni i artit”, ne *Kultura dhe bumi*, f. 200-201, citon: “Arti krijon parimisht një nivel te ri realiteti, i cili dallon prej tij te parit nga një zmadhim i ndjeshëm i lirisë. Liria zhvendoset në ato sfera të cilat në realitet nuk i posedon. Pa-alternativa përfton alternativën. Së këndejmi, dhe vlerësimet etike moshore në art. Pikërisht për shkak të lirisë së madhe, arti gjendet, si të thuash, jashtë moralit. Ai e bën të mundur jo vetëm të ndaluarën, por edhe të pamundurën., prandaj në lidhje me realitetin, arti del në cilësinë e sferës së lirisë. Por vetë ndjesia e kësaj lirie nënkupton vëzhguesin, i cili e kundron artin nga realiteti. Prandaj sfera e artit gjithnjë përfshin ndjesinë e tëhuajsimit. Dhe kjo ndërftu pashmangshëm mekanizmin e vlerësimit etik. Vetë vendosmëria me të cilën etika mohon pashmangësinë e leximit estetik të artit, vetë energjia e cila shpenzohet në dëshmi të tilla, është vërtetimi më i mirë i qëndrueshmërisë. Etikja dhe estetikja janë të përkundërta dhe të pandara si dy pole të artit.”

- Lulja, Lukja ! A s'e kujtoni Luken? S'e besoj... shtiheni... Apo ndoshta do mohoni dhe se enjihni? Me falni, por këtu nuk shkon ajo e famshme: kush guxon - fiton! Kjo shkon ngjeti! Domohoni dhe se e njihni Luken? Me pretekst se jeni të ndershëm... Te mos kini, të mos kini frige senuk do ju quej të pandershëm. Por ju, së paku, me siguri do njihni ndonjehën nga motratlegjitime të Lukes, asht njësoj si me njoftë Luken vete. Jeta e tyne asht një. Të gjitha janë njësoj dhe të gjitha ju apin atë që kërkoni - me pare në dorë.

E Lukja e mirë, Lukja e mshireplotë - se ajo ishte njelloj hyjneshe - Lukja e dëshrueme me tëvertetë askujt nuk i thoshte jo. Vijshin studentat, jo me ndoj qëllim të keq, vijshin vetëm mepërcjellë ndoj shok i cili gjithashtu ishte student. Kur kryente punë me të parin, Lukja i thoshtetjetrit: sa lekë ke në xhep? - Katër. - Hajde, - i thoshte të dytit, të tretit e të katërtit me radhe dhe i çonte n'od të saj. E pra, taksa e saj ishte tre frangë. Por Lukja ishte ma shpirtmirë, mahumanitare se shum vetë të cilve ashtu i duhet me gen."<sup>1</sup>

Ato janë femra të vogla, në të gjitha kuptimet e mundshme, përballëbotësfemërore të trilluarne traditën letrare paramigjeniane, mbi të gjitha janë **vetmuara**.

Ato janë të vendosura në Qytetin veriut, në një "fshat qe don me u quejt qytet", në rrugica te errëta dhe të pista, ato janë "malësore", me "brekë legjendare mbishtat"... "Aq sa ndonjenit i vinte dhe keq qe e quejnë kurvë, dhe mundoheshin ta zbusnin kuptimin e fjalës tue i thanë prostitutë, grue publike, grue problematike – me emna të cilët i kishin gjetë tuelexue libra. Sidomos njenit, i cili nuk shqiptonte kurrë fjalë të ndyeta, i vinte keq ta quejshinLuken kurvë. Te "Bukuria që vret", stilizohet bukuria e ngrirë, e ngurtë e vdekur me mungesa të etnitetit, të degraduara, të humbura në mjedisin urban. Migjeni e përthyen madhështinë e heroinës së vet, në sprovat e ekzistencës ajo pëson tronditje shpirtërore që e shpie në rrëzimin e kodeve morale. Ai i zhvesh nga krenaria morale. Personazhet janë njerëz realë, jetojnë brendashoqërisë dhe përballen me mekanizmat e funksionimit të saj. Ato kanë pikëpamje të ndryshme mbi jetën duke krijuar një filozofi tipike shqiptare, por edhe një dëshmi universale të qenies. Gruaja martirizon moralin për fëmijën, ndodh shkatërrimi i personalitetit të njeriut në kushtet e një shoqërie despotike. Lukja është çmendur. Ky lloj i jetës së Lukes është vetëmnjë dëshmi tronditëse që ofron qyteti në përballje me realitetin e kohës.

Kadare

Heroina komuniste që ndryshon prej lëvizjeve, rolit, normave, vlerave, ajo ofronkuptimetë reja. Katrina te romani "Dasma"është përfaqësuesee njeriut dhe rendit të ri, ku gjinia është e parëndësishme sepse çdokush duhet të ishte në funksion të ndërtimit të ri. Katrina vishet me të gjitha parimet ideologjike të një sistemi të ri komunist. Katrina ështëshfaqja e ndryshimit ideologjik e cila me anë të saj realizon të gjithë revolucionin në konceptin e ri për femrën. Katrina hedh pas krahëve një dasmë prej kanuni, rreth vetës mbledh grupe sociale të ndryshme; mësuese fshati, tornitorë, studiues antropologjie, prania e të cilëve nënkupton ideologjinë e shpëtimitnga e vjetra. Katrina është femra kolektive, si grua ajo bëhet simbol i mbajtjes së femërores. Ajo përfaqëson modelin e ri të gruas shqiptare, emancipimi i saj lidhet direkt me përfshirjen në ndërtimin e Shqipërisë. As ajo dhe as gratë e tjera te Kadare nuk janë të plota. Në romanet e veta, Kadare shpreh adhurim për karakteret e grave, në thelb ato janë sublime.

Te Kongoli: "Shturja" e variantit tradicional në ndërtimin e heroit letrar femër, ka të bëjë me përthyerjen e disa entiteteve brenda të njëjtit personazh, që sjell "copëzimin" e figurës së protagonistit. Kemi vënë re se personazhi nuk mbushet me tiparet e heroit letrar tradicional, me attribute identitare për t'u kthyer në një heroinë të qëndrueshme. Përkundrazi, autori i ndërton heroinat nëpërmjet attributeve asnjane e negative. Femrat kongoliane kategorizohen nëpërmjet:

<sup>1</sup> Migjeni, përmbledhja *Novelat e qytetit te veriut*, Tiranë 2006, f. 152-160. Historia e njenës nga ato.

mungesës së guximit, forcës, trimërisë, janë mbartëse të veseve të tilla si: egoizmi, padija, fanatizmi, mbartëse të attributeve negative, si amoraliteti, lakmia, apo attributeve neutrale, si konfuzioni, vetë-urrejtja, etj. Heroina kongoliane është një personazh kompleks, i vështirë në dekodifikim, pasiv, i ftohtë emocionalisht, etj., ndaj edhe mund të konsiderohet si “hero” i dështuar ose i shëmtuar.

Personazhi femëror a heroina vjen nga shtesa e njerëzve “të humbur” pasi janë femra që kanë kaluar përvoja traumatike, vuajnë me dhimbje një ekzistencë pa kuptim dhe pothuajse pa motive bindëse për ekzistencën e tyre, i përndjek mendimi i vetëvrasjes që shfaqet më i rëndë se vrasja. Janë femra të vetmuara në aspektin fizik dhe shpirtëror. Disa nuk kanë familje dhe janë të izoluar. Heroina ndjehet inferiore ndaj të tjerëve dhe si e tillë është e përjashtuar. Nuk ka ndonjë formim fetar apo kulturor, përveç kësaj vuan nga ndjenja se është e shëmtuar fizikisht, vuan nga fakti se ushqen një prirje seksuale të panatyrshme ndaj gjinisë femërore. Për shkak të këtyre problemeve ajo ka një shkallë të ulët vetëvlerësimi, si një qenie në shkallën zero të zhvillimit mendor. Ndryshe nga personazhet e tjera ajo e ka shumë të zhvilluar ndjenjën e solidaritetit dhe të përkujdesjes për të tjerët. Por edhe këto janë shenja të një reflektimi për absurditetin e ekzistencës dhe neverisë ndaj jetës. Ndjenjat e absurditetit të qenies së tyre femërore, shpesh burojnë nga përvoja traumatike që ka pësuar personazhi nga e kaluara: vdekja e Anës, mikes së saj nga një plumb qorr, përdhunimi nga një bandë meshkujsh si dhe vrasja e dy vëllezërve në ngjarjet e vitit 1997, pastaj jeta e mbyllur në vilë duke iu shërbyer dy pleqve të vetmuar dhe të sëmurë, duke parë shkatërrimin e përditshëm të jetës dhe të fizikut të tyre etj. Për Parashqevinë vërtet shumë prej meditimeve dhe reflektimeve të saj afrojnë me meditimin ekzistencialist mbi absurdin e ekzistencës, por shkrimtari në vijimësi ka preferuar që këto reflektime e meditime t’i motivojë edhe përmes rrethanës sociale-politike në vazhden e një realiteti të përthyer shqiptar. Ky tip personazhi është viktimë e dukurive që përshkuan tranzicionin e vitit 1997, nuk është thjesht njeriu, qenia moderne me dilema dhe dyshime ekzistenciale, por qenia e dhunuar barbarisht, e tronditur në thellësi të identitetit të saj, aq sa jeta e mëtejshme është e neveritshme për të. Një pjesë e mirë e rrëfimit është një retrospektivë mbi përvojat traumatike të së kaluarës, përvojë e cila eklipson jetën e tashme të personazhit. Parashqevia, femra me prirje seksuale të panatyrshme, që pëlqen seksin me femrat dhe meshkujt. Në këtë aspekt Kongoli tenton të sjellë në vëmendje ‘personazhin e përjashtuar’ dhe ‘të persekutuar’ për shkak të këtyre prirjeve. Në shoqërinë shqiptare kjo kategori e njerëzve jo rrallë bëhet objekt i paragjyqimeve dhe sulmeve, siç ndodh me Parashqevinë e cila për shkak të marrëdhënies që kishte me Anën, pas vdekjes së saj megjithëse nuk kishte asnjë faj ajo bëhet objekti i një përdhunimi kolektiv nga një bandë që prihet nga vëllai i Anës. Në rrëfimin e saj mbi jetën e çiftit të pleqve që banojnë në vilë kemi disa motive: pleqëria, sëmundja, vdekja, solidariteti dhe përkujdesja ndaj njerëzve të moshuar etj.. që e thellojnë mendimin mbi ekzistencën, kuptimin apo absurdin e saj. Në fatin e dy pleqve Parashqevia sheh absurditetin e ekzistencës njerëzore, përballë fotografisë së martesës së tyre ajo konstaton dhe vuan hap pas hapi shkatërrimin e fizikut njerëzor, humbjen e dinjitetit fizik të trupit dhe pastaj vdekjen e tyre.

Heroina kongoliane, lëviz brenda tranzicionit dramatik të shoqërisë shqiptare, ajo është heroikja e pas 90 - ësh që tregon historinë e kësaj kohe<sup>1</sup>.

Në këtë kontekst, kategoria e personazhit femër është një karakter, një portretizim, më pak se një karakter historik, ajo shfaqet si funksion i ekzistencës. Heroina kongoliane është humbëse<sup>1</sup>, e

---

<sup>1</sup> Fatos Kongoli, “*Bolero në vilën e pleqve*”, Tiranë 2009: f. 79. “Qyteti ynë është i çmendur. Qyteti ynë hante njerëz. E kam të pamundur të shoh qytetin tim përveçse si një vazë me ujë ku janë hedhur ca pika me bojë Kine dhe i japin gjithçkaje ngjyrën e zezë. Kjo është ngjyra e vdekjes. Qyteti im më kujton vdekjen (...), f. 77.

pashërueshme, ëndërrimtare, e dobët, me vese, e mbyllur, është e boshatisur nga vlerat e “personazhit me forcë individuale”<sup>2</sup>.

Me heroinën e Kongolit, “tronditet” skema hierarkike e vlerësimit mbi personazhin që vjen si trashëgimi e të kaluarës letrare<sup>3</sup>. Kjo “tronditje” shihet në dy aspekte dhe në dy estetikat krijuese, (moderniste dhe postmoderniste).

Heroina nuk thërret askënd<sup>4</sup>, nuk ka afrimetet mashkullor<sup>5</sup>, nuk di të jetë e dobishme<sup>6</sup>, neverit veten<sup>7</sup>, vë në dyshim ekzistencën e saj njerëzore<sup>8</sup>, me shumë liri në shprehje<sup>9</sup>

---

<sup>1</sup> Po aty, f. 15. Merrja përsipër edhe punë që s’më takonin, të cilat i kryeja pa u mërzhitur. Ishte mënyra ime për të mbijetuar, për t’iu përshtatur një bote, ku një femër si unë mbetet jashtë loje. Në sytë e disa njerëzve duket nuk përfaqësoja thjesht një send të papërfillshëm, pavarësisht nëse kolegët më quanin me ndonjë nofkë të përshtatshme për një femër të shëmtuar, në shkallën zero të zhvillimit mendor, (...), f. 15.

<sup>2</sup> Po aty, f. 231. Tek e fundit, mbeteshja indiferente, ekzistenca e tij nuk i shtonte asgjë kotësisë së ekzistencës sime.

Qytetit nuk i bëhet vonë për fytyrën time të prishur, mendova. Jam një materie që stomaku i tij nuk e bluan. f. 234.

<sup>3</sup> Fatos Kongoli, “*Bolero në vilën e pleqve*”, Tiranë 2009, f. 17. E kam ditur gjithmonë, në këtë botë shanset e mia janë të pakta. E kam ditë qysh se kuptova dhe e futa veten në kategorinë e të shëmtuarave. Për këtë u kam mbajtur inat gjithë jetën prindërve. U mbaj inat edhe sot. Kjo ma ngarkon shpirtin rëndë. Po ndiheshja kafshë pune. f.24. Është një sëmundje e vjetër e imja, me zanafillë kohën kur lexoja shumë dhe e futa veten në kategorinë e vajzave të shëmtuara. Atëherë s’kisha përvojë, përveç pakënaqësisë që isha e shëmtuar. Kjo kuptohet, nuk është përvojë. Dhe asgjë krahasuar me çastin kur pasi ke mbledhur një lloj përvojë, zhgënjyese, arrin të përjetosh kotësinë tënde. S’ka të bëjë me shëmtinë as me bukurinë. Është thjesht zhgënjim nga vetja. f.26. Mua më mundon kotësia e ekzistencës sime. Në periudha të ndryshme, kotësinë time unë e mbush me kotësinë e të tjerëve. f. 29. Shpirt introsigjent. f.35. S’kam për qëllim të mallëngjej njeri. Edhe nëse dikujt i vjen keq, gjasë të cilën nuk e besoj, keqardhja për tjetrin te ne është një fjalë që e gjen vetëm në fjalorin e gjuhës shqipe, nëse ndërkaq nuk e kanë fshirë prej andej si të pakuptimtë pra edhe nëse dikujt i vjen keq, lutem të qetësohet. Do të ishte një keqardhje e kotë. S’kam nevojë për keqardhje, kjo në vend që të më ngushëllojë, më ngre nervat. f. 78.

<sup>4</sup> Po aty, f. 8. Ai nuk thërriste askënd atje, aq më pak një infermiere të rëndomtë si unë.

<sup>5</sup> Po aty, f. 11. Unë nuk isha mësuar të trajtohesha me kaq afërsi mashkullorë. Dirina m’i kishte lejuar të gjitha. Domethënë t’ia thithja buzët, t’ia kafshoja, ndërsa ajo rënkonte, unë bridhja nëpër trupin e saj, i ngacmoja me majën e gjuhës thimthat e gjinjve, e ajo më shtynte të shkoja poshtë, midis këmbëve të hapura dhe ndiheshja e dërrmuar, e pazonja t’i shpëtoja terrorit të trupit të saj. f. 105.

<sup>6</sup> Po aty, f. 11. Nuk e di përsë mund të jem e dobishme.

<sup>7</sup> Po aty, f. 12. Po ç’nevojë mund të kishte ai njeri për një qenie si unë? “Teveqe!”, mendova, si nuk e kupton? Je një qenie në shkallën zero të zhvillimit mendor. Ja përsë të kanë zgjedhur. Ndryshe sikur ajo punë të ishte e lakmueshme, nuk do të vinte radha ty. f. 18. Vështrimi në pasqyrë për mua është një torturë. Shpesh marr vendim të mos shihem më nga frika se një ditë do të më hipë t’i theyë pasqyrat e shtëpisë, tri copë gjithsej, një në banjo, një në dhomën e dheut, e fundit, më e madhja, në korridor. Kjo është një mendjeshkrepje, së cilës nuk ia dal t’i përmbahem. Dua, s’dua detyrimisht i dorëzohem njëres prej pasqyrave. Me raste të triave radhazi, për të konstatuar të vërtetën e përhershme: Jam një femër e shëmtuar. E bindur në çiltërsinë e pasqyrave me gjithë yshtjen për t’i thyer, unë nuk e kryej një veprim të tillë. Nuk është faji im që fytyra ime del ashtu si del. f. 21.

<sup>8</sup> Po aty, f. 14. E shkreta Hipopotam, më kishte ngjallur gjithmonë mëshirë. Jo vetëm sepse më dukej si një kafshë e lodhur. Tek ajo unë shihja vetveten. Ashtu si Hipopotami, e fusja veten në kategorinë e femrave të shëmtuara. f. 14. I kërkova ndihmë fytyrës sime serioze me t’i vënë pleqtë të flinin. “Më jep një këshillë iu luta, po luaj mendsh!” Ajo më vështroi me përbuzje. “Më ndihmo, e kërcënova, ndryshe do të theyë pasqyrën!” Për ta provokuar më tej, zura të zhvishesha. Asgjë nuk e nervozonte më shumë se striptiza ime mjerrane. Ajo vetëm qeshi, gjithnjë përbuzëse. Me lotët në grykë i ktheva shpinën. f. 135. Do të jem vetëm, e braktisur, askush s’do të vijë të luajë me mua komedi të shpëlara dhe e gjithë bota do të lëshojë psherëtimë lehtësimi sapo ta marrë vesh vdekjen time. f. 134.

<sup>9</sup> Po aty, f. 34. Tek e shihja më lindi një pyetje e paturpshme: sa herë duhej ta kishin bërë ata deri ndaj të gdhirë. Me seriozitetin e një mjeshtri në lëmin e dobësive femërore: para tij ndiheshja lakuriq. f. 55. Po ti, zonjushë, mu drejtua, masturbohesh? f. 71. Masturbimi nuk është vetëm veprimi që në gjuhën shqipe, si e vure në dukje, shprehet me fjalët “t’i biesh me dorë”. f. 71. Njëherazi, të frenoja dëshirën e egër të syve të mi për të vajtur te buzët e saj. f. 75-76. Gjijnjtë e mi të vegjël, aq të vegjël, aq të vegjël sa më vinte zor t’i shihja, kërkonin numrin më të vogël të mundshëm të sutienave. Edhe këshu, më duhej të përdorja nga ato të veshura me sfungjer, të cilat gjivoglave u krijojnë iluzionin e gufimit të nevojshëm për nxitjen e nepsit mashkullor, atyre me gjinj normal ose të mëdhenj, u shërbejnë si mbajtëse, për të mos lënë varjen e gjinjve, më shumë për t’u krijuar formën agresive. f. 83.